



Financuar nga  
Bashkimi Evropian



## KONVENTA KOMBËTARE PËR INTEGRIMIN EUROPIAN

### GRUPI I PUNËS PËR KAPITULLIN 24: Drejtësia, Liria, Siguria

#### Forcimi i kapaciteteve ligjzbatuese përmes arsimit policor dhe bashkëpunimit ndërkombëtar: roli i Akademisë së Sigurisë në procesin e integrimit evropian

07 prill 2026, 11:00 – 13:00

#### Kërkimi shkencor, rritja akademike dhe sfidat e zhvillimit teknologjik

- Sipas praktikës sllovaqe rekomandohet një kombinim i plotë **mes teorisë dhe praktikës** në të gjitha nivelet e studimit (Bachelor, Master, Doktoraturë), si dhe në mësimin e vazhdueshëm pas studimeve. Të diplomuarit duhet të jenë të pajisur me njohuri teorike dhe aftësi praktike për të hartuar dhe zbatuar masa efektive në fushën e sigurisë dhe ligjit. Ata duhet të jenë të aftë të analizojnë mjediset e sigurisë, të menaxhojnë rreziqet dhe të reagojnë ndaj situatave emergjente.
- Rekomandohet **forcimi i komponentit të të drejtave të njeriut dhe njohjes së legjislacionit të Bashkimit Evropian** në programet e trajnimit dhe kurrikulën e Akademisë së Sigurisë, në kuadër të Kapitullit 23 dhe Kapitullit 24 të negociatave me BE-në. Kjo përfshin rritjen e fokusit në standardet europiane të procedurave hetimore, garantimin e të drejtave themelore, mbrojtjen e grupeve vulnerabël dhe respektimin e shtetit të së drejtës gjatë ushtrimit të detyrës nga strukturat ligjzbatuese, në funksion të përafrimit me acquis të Bashkimit Evropian.
- **Mësimi i gjuhëve të huaja**, veçanërisht anglishtja, duhet të konsiderohet prioritet dhe të forcohet më tej. Në këtë drejtim, Akademia e Policisë në Sllovaki ka një departament të dedikuar për gjuhët e huaja, ku ofrohet mësim i gjuhës angleze, me fokus në komunikimin profesional në polici dhe administratë publike.
- **Kërkimi shkencor** duhet të ketë prioritet në akademi si pjesë e modernizimit të praktikave dhe teknikave. Kërkohet bashkëpunim më i madh me akademikë, studiues dhe ekspertë të fushave të ndryshme për të adresuar nevojat dhe problematikat në fushën e sigurisë. Në rastin e Shqipërisë, fokusi duhet të jetë

*\*Ky sesion i Grupit të Punës për Kapitullin 24 zhvillohet në kuadër të projektit "Ndërtimi i Partneritetit mbi Bazat: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE", me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian – Instrumenti i Shoqërisë Civile IPA 2021, i cili zbatohet nga Lëvizja Evropiane në Shqipëri dhe në bashkëpunim me Akademinë e Integrimit Evropian dhe Negociatave (AIEN), Shoqatën Sllovaqe të Politikës së Jashtme (SFPA) dhe Qendrën për Transparencë dhe Liri Informacioni (CTFI)*



Financuar nga  
Bashkimi Evropian



edhe në procesin e integrimit evropian dhe negociatave, si dhe në bashkëpunimin me agjencitë e BE-së dhe partnerët rajonalë. Kërkimi shkencor duhet të prodhojë rezultate praktike dhe të zbatueshme në punën policore dhe të sigurisë.

- **Ndërkombëtarizimi i Akademisë së Sigurisë së Shqipërisë** është thelbësor, ku bashkëpunimi ndërkombëtar luan rol kyç në përmirësimin e cilësisë në arsim dhe kërkim. Bashkëpunimi me CEPOL, si dhe përfshirja në SOCTA dhe EMPACT, ndihmon në përditësimin e kurrikulave, zhvillimin e mendimit analitik dhe lidhjen më të fortë mes teorisë dhe praktikës.
- Rekomandohet rritja e përfshirjes së Akademisë së Sigurisë në **programet dhe instrumentet e Bashkimit Evropian** si Erasmus+, Horizon Europe dhe iniciativa të tjera të bashkëpunimit akademik dhe kërkimor. Aktualisht, mungesa e pjesëmarrjes së plotë në këto programe kufizon mundësitë për shkëmbim eksperiencash, zhvillim të stafit akademik dhe modernizim të kurrikulave. Përfshirja në këto skema do të kontribuonte drejtpërdrejt në forcimin e kapaciteteve profesionale, ndërkombëtarizimin e institucionit dhe përafrimin me standardet e BE-së në fushën e arsimit policor dhe sigurisë.
- Shfrytëzimi i mundësive **teknologjike dhe përdorimi më i madh i mësimin elektronik (e-learning)** është gjithashtu i rëndësishëm. Platformat e trajnimit ofrojnë kurse online, shkëmbim njohurish, akses në materiale studimore dhe mundësojnë standardizimin e trajnimeve në nivel evropian, duke modernizuar procesin mësimor.
- Inteligjenca artificiale përbën sfidë për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor. Për të minimizuar problematikat që vijnë nga përdorimi i IA por edhe për ta përdorur atë në mënyrë të saktë, disa masa mund të ndërmerren. Sipas eksperiencës sllovaqe, masat përfshijnë:
  - *udhëzues për përdorimin e inteligjencës artificiale për studentët dhe stafin akademik*
  - *trajnime të detyrueshme për studentët dhe stafin akademik mbi përdorimin etik dhe të saktë të IA*

*\*Ky sesion i Grupit të Punës për Kapitullin 24 zhvillohet në kuadër të projektit "Ndërtimi i Partneritetit mbi Bazat: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE", me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian – Instrumenti i Shoqërisë Civile IPA 2021, i cili zbatohet nga Lëvizja Evropiane në Shqipëri dhe në bashkëpunim me Akademinë e Integrimit Evropian dhe Negociatave (AIEN), Shoqatën Sllovaqe të Politikës së Jashtme (SPPA) dhe Qendrën për Transparencë dhe Liri Informacioni (CTFI)*



Financuar nga  
Bashkimi Evropian



- *metoda alternative vlerësimi (praktika, internshipe, teste dhe produkte praktike)*

## Trajnime dhe ngritja e kapaciteteve

- Trajnimi i vazhdueshëm është një element i rëndësishëm për ngritjen dhe përmirësimin e kapaciteteve të oficerëve të policisë që janë tashmë në detyrë. Një praktikë e ardhur nga eksperiencia sllovaqe rekomandon që **këto trajnime të jenë të detyrueshme për stafin**, bazuar në profilizimin dhe nevojat e tyre, duke bërë të mundur që ata të jenë vazhdimisht të përditësuar me njohuritë e nevojshme.
- Çështjet prioritare për trajnim duhet të lidhen me **zhvillimet më të fundit** në teknologji dhe sigurinë kibernetike, të drejtat e njeriut me fokus fëmijët dhe grupet vulnerabël, si dhe kurse të dedikuara për profile të ndryshme detyre, përfshirë: studime të specializuara policore, trajnime për menaxhimin policor, kurse për attaché policor, kurse për komunikim joverbal, kurse të specializuara për hetimin e korrupsionit
- Një incentivë për rritjen e profesionalizmit të studentëve dhe oficerëve të policisë është **certifikimi dhe autorizimi i tyre** në disa fusha, si kontrolli i nivelit të alkoolit/drogës, kontrolli i shpejtësisë dhe përdorimi i armëve të zjarrit.
- Është shumë e rëndësishme forcimi i kapaciteteve dhe aftësive **në fushën e teknologjisë**, për shkak të rritjes së rreziqeve kibernetike dhe zhvillimit të inteligjencës artificiale, të cilat kërkojnë përgjigje të shpejtë dhe efektive. Këto trajnime duhet të zhvillohen **me përfshirjen e ekspertëve** nga vendet anëtare të BE-së, por edhe ekspertëve të fushave të ndryshme.